



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 143, datë 27.04.2021

PËR TRANSFERIMIN E PROKURORIT

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 44 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Transferimin e prokurorit **Erion Çela** nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe caktimin në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, shpallur me Vendimin nr.334, datë 29.12.2020.
2. Të njoftohen për këtë vendim z. **Erion Çela**, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
MOISI DUDA

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI